



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

PËR	z. Bali MUHARREMAJ- Kryetar i Komunës në Suharekë
PËR	z. Bexhet KUÇI-Kryesues i Kuvendit të Komunës në Suharekë
NGA	Zyra Ligjore dhe për punë të Kuvendit Komunal
LËNDA	Raport pune për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021
DATË	05 janar 2022

I nderuar, z. Muharremaj dhe z. Kuçi

Zyra Ligjore dhe për punë të Kuvendit Komunal, gjatë këtij vitit 2021, ka kryer punët në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe dispozitat tjera të akteve nënligjore dhe rregulloreve të punës të cilat janë në kompetencë të tyre dhe të autorizimeve të marruar nga organi kompetent.

Përmbajtja:

Raporti përmban:

- Aktivitetin politik/ legjislativë të Kuvendit të Komunës
- Aktivitetet e pjesës ekzekutive të Kryetarit të Komunës

Pushteti i tanishëm lokal është konstituar në bazë Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008” me datën 26.11.2021, është bërë konstituimi i pushtetit legjislativ dhe a’i ekzekutiv si dy organe shumë të rëndësishme për implementimin e të gjitha strategjive politike, për zhvillimin ekonomik lokal të Komunës tonë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese të vitit 2021, janë mbajtur mbledhjet si më poshtë:

1. Kuvendi i Komunës (Asambleja) e cila ka mbajtur 12, (dymbëdhjetë) mbledhje të rregullt dhe mbledhjen inauguruese me datën 26.11.2021 ku është bërë konstituimi i pushtetit legjislativ dhe a’i ekzekutiv;
2. Komitetit për Politik dhe Financa ka mbajtur 12, (dymbëdhjetë) mbledhje të rregullt;
3. Komiteti për Komunitete ka mbajtur 12, (dymbëdhjetë) mbledhje të rregullt;
4. Këshilli komunal për siguri në bashkësi (KKSB-ja) ka mbajtur 6, (gjashtë) mbledhje, të rregullt;

Gjatë kësaj periudhe nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, janë miratuar gjithsej **31 (tridhjetë e një) akte administrative**, më të cilat akte administrative rregullohet një rast, apo një çështje e ndarë dhe konkrete brenda territorit të Komunës së Suharekës dhe ata janë;

1. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores, 01-nr-16-7790 për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe studentë/e të komunës së Suharekës
2. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Suharekës-Gelancë
3. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së

4. Suharekës-Duhelë
5. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Suharekës-Shirokë
6. Vendimi për ri-alokimin e mjeteve nga fondi burimor (22), të hyrat veanake të vitit 2019 në Subvencione dhe Transfere në vitin fiskal 2021
7. Vendimi për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës
8. Vendimi për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës
9. Vendimi për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të realizuara në vitin 2019 dhe 2020, të bartën për shfrytëzim në vitin fiskal 2021
10. Vendimi për ri-alokimin e mjeteve brenda fondit burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2021 nga projektet kapitale
11. Vendimi për emertimin e QKMF-se
12. Vendim Për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor 2020**.
13. Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Suharekës-Samadrxe
14. Vendimi për plotsim ndryshimin e vendimit 01-nr-104-62558 të datës 27.09.2018
15. Vendimi për caktimin e lokacioneve për trafostacione të KEDS-it
16. Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit (1) të pronës së paluajtshme të komunës
17. Vendimi për caktimin e vlerës së bonus banimit
18. Vendimi për shfuqizimin e vendimeve
19. Vendimi për ri-alokimin e mjeteve brenda fondit burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2021 nga projektet kapitale
20. Vendim për lirimin nga pagesa e qeras për gastronominë
21. Vendimi për lirimin nga pagesa e qiras dhe faljen e borxhit të pa paguar
22. Vendimi për miratimin e raportit për vitin 2020, të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A
23. Vendimi për formimin e komisionit përzgjedhës
24. Vendimi për pagesën e shujtës për të gjithë nëpunësit në administratën e Komunës së Suharekës
25. Vendimi për ti ndihmuar klubit sportive të “Ballkani” në Suharekë
26. Vendimi për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal-2021-2029 (PZHK)
27. Vendimi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit
28. Vendimi për themelimin e komiteteve të përhershëm
29. Vendim për emërimin dhe plotësohet me anëtarë Komitetin për Politikë dhe Financa
30. Vendim për emërimin dhe plotësohet me anëtarë Komitetin për Komunitete
31. Vendimi për miratimin e të hyrave e të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2022.

Janë miratuar dy (2) Rregullorja dhe gjithsej (njëzetë e nëntë) (29) vendime

Të gjitha këto vendime dhe Rregullore janë dërguar në Ministrinë administrimit të pushtetit lokal në Prishtinë, konform nenit 81, të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave, për shqyrtim dhe harmonizim të ligjshmërisë dhe nuk kemi pasur ndonjë rekomandim apo vërejtje nga ana e tyre për këtë çështje, çka do të thotë nuk kemi bërë tejkallim të kompetenca si organ legjislativ.

Zyra Ligjore dhe për punë të Kuvendit Komunal, njëkohësisht ka përgatitur aktvendime, vendime, udhëzime, urdhëresa, marrëveshje, kontrata, kërkesa, ankesa, njoftime si dhe shkresa të ndryshme për Kuvendin e Komunës në Suharekë dhe për Zyrën e Kryetarit të Komunës, po ashtu ka ofruar ndihmë (udhëheqje) juridike, shërbime, këshillime dhe kemi bërë ekspertizë për drejtori, zyra dhe sektorë, institucionet e arsimit, të shëndetësisë dhe ndërmarrje komunale si dhe duke ju ndihmuar në hartimin e procesverbaleve.

Qëllimi i raportit:

Qëllimi i këtij raporti konsiston në paraqitjen kronologjike të gjitha aktiviteteve kryesore që ka pasur-Aktiviteti politik/legjislativi dhe aktivitetet e pjesës ekzekutive për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021.

Ky raport pasqyron aktivitetet që kanë dalë gjatë muajt janar-dhjetor të këtij viti 2021 dhe që lidhen drejtpërdrejt me prioritetet e vendosura për këtë periudhë kohore.

Me respekt,